**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 92, datë 26.07.2021

**PËR**
**MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 8,985,373.3 (TETËMILION E NËNTËQIND E TETËDHJETË E PESËMIJË E TREQIND E SHTATËDHJETË E TRE LEKË E TRIDHJETË QINDARKA), PËR PASURITË, PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI "RIKONSTRUKSIONI DHE NDËRTIMI I RRUGËVE "KSANTHIPI ZYKO" DHE "ABDYL YPI"**

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, VKM-së nr. 395, datë 13.05.2021 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**VENDOSI:**

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 8,985,373.3 (tetëmilion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e treqind e shtatëdhjetë e tre lekë e tridhjetë qindarka), për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e

vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimit, që preken nga investimi "Rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve " Ksanthipi Zyko" dhe " Abdyl Ypi".

2. Fondi i shpronësimit me vlerë 8,985,373.3 (tetëmilion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e treqind e shtatëdhjetë e tre lekë e tridhjetë qindarka), të parashikohet në buxhetin e vitit 2022. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.

3. Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria Ligjore të ndjekë proçedurën e shpronësimit me Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

**U shpall sot me datë 26.07.2021**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA DURRËS**

Nr. 9992 Prot. Durrës, më 24/5/2019

Lënda : Raport mbi vlerësimin paraprak të pasurive të pa luajtshme, pronë private që preken nga investimi "Rikonstruksion dhe ndërtimi i rrugës Ksathipi Zyko dhe Avdyl Ypi"

**DREJTORISË JURIDIKE**

**Këtu**

Në zbatim te urdhërit Nr 397 datë 06. 12 . 2017 "Për vleresimin paraprak të pasurivet ë paluajteshme prone private që preken nga investimi " Rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve Ksanthipi Zyko dhe Abdyl Ypi" grupi i punës informon :

**1.** Hartimi i Planimetrise se Shpronesimeve (Planvendosje Ilustruese) dokumentacioni teknik baze per evidentimin e pasurive qe preken nga ndertimi i Veprave Puplike.

1.1 U kerkua, u informua dhe u sigurua ne rrugë operative

- Projekti i vepres " Rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve Ksanthipi Zyko dhe Abdyl Ypi"

Gjurma e Kufijve të Vepres (sipas projektit me spjegimin përkatës)

- HTR e Zonave Kadastrale 8513 (dwg jo zyrtare e rregjistrimit fillestar)

1.2 Përputhja ( Pozicionimi ) i Gjurmës së Projektit në HTR e ZK 8513 (si kriter përputhja e objekteve kapitale - Ish URT )

Përfitimi i Hartës së punës për krijimin e planimetrisë së shpronësimeve

1.3 Në planimetrinë e shpronësimeve rast pas rasti bëhet evidentimi i i pasurive që preken nga kufijtë e veprës si dhe përpilimi i listës bruto me numrat e pasurive. ( nga dwg e rregistrimit fillestar të Zk 8513).

1.4 Lista e pasurive që preken nga projekti i rrugës është nisur me kërkesën përkatëse në ZRPP për statusin dhe konfigurimin aktual të pronave (korrespondenca përkatëse, shkresa me Nr. 21623 prot, datë. 27.12.2017).

1.5 Me shkresën Nr. 7979, datë, 04.09.2018, protokolluar në Bashkinë Durrës me Nr. 15486. datë 06.09.2018, ka ardhur kthim përgjigje nga ZVRPP për statusin e pronësive të kërkuara (kartela dhe fragment kopje harte). **Fragmenti i Kopjes së Hartes për pasuritë e kërkuara, rezultoi i palexueshëm dhe i pa aksesueshem për identifikimin e pasurive.**

1.6 Përsa më siper, kemi informuar autoritet tona për pamundësinë e zbatimit të proçedurave komplete të shpronësimit për intëtes publik (sipas urdherit të punës).

1.7 Në vijim udhëzimeve verbale nga autoritetet, vijoi me proçedurë të përshpejtuar përgatitjen e dokumentacionit të shpronësimit paraprak vetëm për pasurinë Nr. 2/643.

1.8 Për sa përmendet në pikën 1.7, u konsiderua e pa mjaftueshme dhe u kërkua vazhdimi i proçedurave për të gjitha pasuritë që preken nga investimi në objektin, **"Rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve Ksanthipi Zyko dhe Abdyl Ypi "**

1.9 Për zabatimin e këtij urdhëri të dytë verbal të autoriteteve, grupi i punës u interesua në rrugë operative pranë ZRPP për të siguruar ndonjë planshtë (hartë), më pak të dëmtuar dhe më të plotë. Mbas kontakteve me punonjësit e ZRPP, u mësua se harta e punës me indeksin përkatës ishte kopje e vetme dhe shumë e dëmtuar.

1.10 Në situatë e krijuar grupi i punës me shkresë Nr. 8816. datë 02.05.2019 ju drejtua përsëri ZRPP, për informcion mbi statusin juridik të pasurive që preken nga invesitimi, (kartelë dhe kopje harte).

1.11 Me shkresën Nr. 4576/1, datë 23.05.2019 të ZRPP, protokolluar në Bashkinë Durrës me Nr. 8816/1, datë 23.05.2019 ka ardhur kthim pergjigje nga ZVRPP për statusin aktual të pronësive të kërkuara dhe transformimet që kanë pësuar këto pasuri, (kartelat aktuale përkatese, fragmente harte). Fragmenti i Kopjes së Hartës për pasuritë e kërkuara (në pamundesi të Planshetës së punës) jepet nga referencat e praktikave të veçanta.

1.12 Referuar statusit të pasurive rezulton që pasuritë e paluajteshme pronë private që preken nga investimi i sipercituar janë 4, përkatësisht 2/927, 2/929, 2/997, 2/643 në ZK 8513 ( pasuria 2/643 sipas kartelës së pasurisë ka brënda saj dhe një godinë 1k)

1.13 Në vijim u proçedua për pasuritë 2/927, 2/929, 2/997, 2/643, në ZK 8513. Kryhet përputhja e gjurmës projektit me skanimin e HTR pjesore të statusit aktual të pronësive .

1.14 Referuar Projektit e kufijve të vepres si dhe konfigurimit gjeometrik të pronave në HTR u përgatit Harta e punës për paraqitjen ilustruese të pasurive në ZK 8513, (matjet sipërhaqet opsionet autocad - për pjesën e prekur - planvendosja ilustruese )

## 2. Vlersimin Paraprak të pasurive të sipër cituara, (tabela përmbledhëse)

| Vleresimi paraprak i pasurive (PRONAT) qe preken nga investimi rruga "Ksanthipi Zyko + Abdyl Ypi" Rajoni 5 , L17 , Durres | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Pronari | | 8518+ Indeksi i Hartes | Nr pasurise | Siperfaqja | | shkrese ZVRPP nr 7979, dt 04.09.2018 | | Vlera | | Shenime |
| | | | | | Toka (trualli) | Ndertim | Toka (truall) | Ndertim | Toka (truall) | Ndertim | |
| | Emri | Mbiemri | | | m² | m² | lek / m2 | lek / m2 | leke | leke | |
| 1 | Albert | Abazi | 8513 DR-H6 | 2/927 | 192.0 | | 12,945.0 | | 2,485,440.0 | | Shpronesim |
| 2 | Albert | Abazi | 8513 DR-H6 | 2/927 | 28.0 | | 12,945.0 | | 362,460.0 | | Zhvleftesim |
| 3 | Albert | Abazi | 8513 DR-H6 | 2/929 | | 20.0 | | 54,595.0 | 0.0 | 1,091,900.0 | Cmim Snd-S t |
| 4 | Nurie | Falli | 8513 DR-H6 | 2/643 | 75.94 | 59.0 | 12,945.0 | 67,540.0 | 983,043.3 | 3,984,860.0 | 134T-59nd |
| 5 | Xheko | Taipi | 8514 DR-H6 | 2/997 | 6.0 | | 12,945.0 | | 77,670.0 | | |
| | | | | | | | | | 3,908,613.3 | 5,076,760.0 | |
| | Vlera Total | | | | | | | | 8,985,373.3 | | |

Për vlerësimin dhe llogaritjen e masës së shpërblimit të pasurive, sipas kritereve të ligjit Nr. 8561 datë 22.12.1999 " Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik". VKM 138 , date 23.03.2000 " Për kriteret teknike të vlerësimit dhe llogaritjes së masës së shpërblimit", si dhe referuar ( shkresa e ZRPP me nr prot 7979 date 04.09. 2018) rezulton cmimi te ZK 8513, **12 945.00 lek/m2 S truall, 67 540.00 lek/m2 S ndertim.**

2.1 Ne lidhje persa kerkohet ne piken 2/b te urdherit Nr 397 date 06. 12 . 2017 për vleresimin e objekteve , me përgjegjësinë dhe seriozitetin që na ngarkon detyra e ne mungesë të formimit profesional (asnje nga anetaret e e grupit nuk është vlerësues pasurie) shprehim pamundesinë e vleresimit të detajuar analitik siç përshkruhet në atë paragraf dhe në mbështetje dhe referencës e të juridiksionit në fuqi , është operuar me kriterin lek/ m2, për vlerësimin e pasurive si truall dhe ndertesë.

**Grupi i punës rezervon të drejten të rishikojë përfundimet e arritura për çdo ndryshim të pritshëm përkatësisht :**

- Të gjithë udhezimeve plotësuese që rrjedhin nga zbatimi i ligjit, akteve dhe udhezimeve ne fuqi.
- Të projektit (ndryshim aksi, gjurme , përmasa)
- Të gjëndjes fizike të objekteve dhe statusit aktual të pasurive si në konfigurim dhe në siperfaqe.

3. **Bashkëngjitur dorezojmë dokumentacionin teknik dhe ligjor**
   - Projektin e segmenteve perkatese te rrugeve
   - Kartelat e pasurive përkatëse (sipas shkesës Nr 8816/1, datë 23.05.2019 të ZRPP).
   - Plan vendosje orientuese të pasurive që janë prekur nga investimi, (gjurma e projektit mbi fragment HTR)
   - Korespondenca përkatese me institucionet
   - Foto të gjendjes ekzistuese.

Për grupin e Punës

Ark. A. Tocila
Spec/inxh. I . Tomori
Jurist. V. Rrutja

***Foto të gjëndjes ekzistuese në segmentin rrugor K. Syko dhe A. Ypi.***

# Planimetria e shpronesimeve

( Harta e Punes )

Paraqitja grafike orientuese e pasurive private qe preken nga Investimi

## rruga " Ksanthipi Zyko - Abdyl Ypi " ,

projekti i ndryshuar

## ZK 8513 Rajoni 5, L17, Durres

Shkalla 1 : 500




2/500
2/505
2/927
28 m² (T)
2K
2/639
2/927
192 m
2/929
20 m² (Snd)
2/645
2/627
2/499
2/643
N
6K
2/628
2/643
134 m²
59.0 m²
2/646
2K
/518
2/476
2/462
77
2/474
5K
2/478
2K
2/480
2/638
2/479
2/637
6 m² (T)
5/42

**TABELA E HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS**

Lista e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga investimi "Rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve "Ksanthipi Zyko" dhe "Abdyl Ypi"

| **Pronari** | | | | **Sipërfaqja që shpronësohet M²** | | **Çmimi në lek/m²** | | **Vlera totale për shpronësim lekë** | **Shënime** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Emri** | **Mbiemri** | **ZK** | **NR. Pas.** | **Tokë Truall** | **Ndërtim** | **Tokë Truall** | **Ndërtim** | | |
| Albert | Abazi | 8513 | 2/927 | 192.0 | - | 12,945.0 | - | 2,485,440.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| Albert | Abazi | 8513 | 2/927 | 28.0 | - | 12,945.0 | - | 362,460.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| Albert | Abazi | 8513 | 2/929 | - | 20.0 | - | 54,595.0 | 1,091,900.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| Nurie | Falli | 8513 | 2/643 | 75.94 | 59.0 | 12,945.0 | 67,540.0 | 4,967,903.3 | |
| Xheko | Taipi | 8514 | 2/997 | 6.0 | - | 12,945.0 | - | 77,670.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| Vlera Totale tokë truall | | | | 301.94 | | 12,945.0 | | **3,908,613.3** | |
| Vlera totale Ndërtim | | | | | 79 | 54,595.0<br>67,540.0 | | **5,076,760** | |
| **Vlera Totale** | | | | | | | | **8,985,373.3** | |

BASHKIA DURRES
8539/3
30.07.21 Nr. PROT

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 549/5 prot. Durrës, më 30.07.2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.92 datë 26.07.2021 "Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 8,985,373.3 (tetëmilion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e treqind e shtatëdhjetë e tre lekë e tridhjetë qindarka), për pasuritë, pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi "rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve "Ksanthipi Zyko" dhe "Abdyl Ypi"

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS